



MF - 270 MATIFIN 50 DURIFIN



PAKETIMI

25 kg



RAPORTI I PERZIERJES

5.5-6 L / 25kg



KONSUMI

1.5 kg/m²

Përkufizimi i Produktit

MF-270 MATIFIN 50 DURIFIN është një llaç me bazë çimento për suva të hollë i përmirësuar me aditivë specialë që mund të aplikohet me dorë ose me makineri.

Veçoritë

- Ka fuqi të lartë ngjitëse.
- Krijon një sipërfaqe të sheshuar dhe të qëndrueshme.
- Rezistues ndaj cikleve të ngrirje-shkrirjes.
- Mund të zbatohet në trashësi 3 deri në 10mm.
- Lehtësisht i punueshëm.

Udhëzimi për Zbatimin e Produktit

- Duhet treguar kujdes që sipërfaqja të jetë e trajtuar dhe të jetë e qëndrueshme në funksion të qëllimit të përdorimit.
- Sipërfaqja duhet të jetë e pastruar nga mbetjet që pengojnë ngjitjen.
- Zonat e shkëputura, plasaritura dhe të thyera duhen riparuar me MATIART.
- Para zbatimit sipërfaqja duhet lagur ose për të marrë një rezultat më të mirë duhet trajtuar me MP-809 ACRYPRIME ose me MP-819 BETOPRIME. Nëse produkti do të zbatohet mbi punime betoni (të pa-suvatuar) atëherë duhet përdorur patjetër MP-819 BETOPRIME.
- 25 kg MF-270 MATIFIN 50 DURIFIN duhet zbratur me ngadalë në 5,5 – 6,0 L. ujë të pastër dhe duhet përzier derisa të përfitohet një masë homogjene pa tokla. Përzierja duhet bërë me mikser në xhiro të ulëta. Nuk duhet shtuar asnjë aditiv (lëndë shtesë) që nuk është i shkruar në udhëzimin e zbatimit të produktit.

-Llaçi i përgatitur duhet lënë 5-10 minuta për t'u bërë gati për përdorim dhe duhet përzier përsëri 1-2 minuta para zbatimit.

-MF-270 MATIFIN 50 DURIFIN duhet zbatuar me mallë çeliku në një dorë me trashësi që nuk duhet të kalojë 10 mm. Për aplikimi më të trasha se 10 mm duhet pritur të kalojë të paktën një ditë.

-Që sipërfaqja të marrë pamjen e fundit duhet lëmuar me sfungjer të lagur.

-Pas aplikimit të produktit sipërfaqja duhet njomur në orare të caktuara për 7 ditë me radhë. Kjo kohëzgjatje mund të shkurtohet në aplikimet që bëhen në muajt e verës dhe mund të zgjatet në muajt e dimrit.

-Llaçi në enë që i ka kaluar koha e përdorimit apo ka zënë cipë duhet hedhur poshtë. Kushte atmosferike të tilla si: temperaturë e lartë, lagështi e ulët, erë mund ta shkurtojnë kohëzgjatjen e punueshmërisë së produktit.

-Pas zbatimit të produktit duart dhe veglat e punës duhen larë me ujë të bollshëm.

Jetëgjatësia në Raft

12 muaj në ambient të thatë dhe ambalazh të pahapur.

Magazinimi

Produkti i paketuar në thasë letre të ruhet në vend të thatë. Thasët të vendosen në stiva e shumta me nga 10 kate.

SKEDA TEKNIKE (NË +23°C DHE 50% U.R.)

Forma	Pluhur
Ngjyra	Gri / E bardhë
Magazini	12 muaj nëse ruhet në paketimin origjinal të mbyllur, në një vend të thatë
Raporti I përzjerjes	6-7 litra ujë / 25 kg pluhur gri 6.5-7.5 litra ujë / 25 kg pluhur I bardhë
Trashësia	3-10mm për shtresë
Koha e punueshmërisë	4 Orë
Dendësia e llaçit të ngurtësuar (EN 1015-10)	1500 ± 100 kg/m ³
Rezistenca në shtypje e llaçit të ngurtësuar (EN 1015-11)	≥ 6 N/mm ² CS IV
Forca e lidhjes - Lloji i thyerjes (EN 1015-12)	≥ 0.4 N/mm ²
Koeficienti i thithjes së ujit për shkak të veprimit kapilar të llaçit të ngurtësuar (EN 1015-18)	≤ 0.40 kg/m ² dk ^{0.5} /W1
Koeficienti i përshkueshmërisë nga avujt e ujit	≤ 15μ
Temperatura e aplikimit	(+5°C) - (+35°C)
Reagimi ndaj zjarrit	A1
Lëshimi i substancave të rrezikshme	Shiko SDS